



Datë: 07.11.2025

Numër protokolli: 7239/2025

A.nr.1739/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1739/2025, të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesja F.R, nga Vitia, kundër organit të punësimit: Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 07.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1739/2025, e datës 26.09.2025, e parashtruar nga ankuesja F.R.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 05.09.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore për refuzimin e aplikacionit të ankueses i ndryshuar në arsyetim sipas këtij vendimi dhe Njoftimi i datës 25.09.2025 dhe 26.09.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës për përfundimin e procedurës së rekrutimit me Nr. Reference:RN00018314 për grupin e marrëdhënieve me publikun dhe informimin për pozitën “*Zyrtar i Lartë për Informim*”.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, F.R (*tutje referuar: Ankuesja*), me datë 25.06.2025 përmes emailit ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më datë 26.09.2025, kundër Njoftimit të datës 05.09.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, për refuzimin e aplikacionit, lidhur me konkursin me Nr.RN00018314 për grupin e marrëdhënieve me publikun dhe informimin për pozitën “*Zyrtar i Lartë për Informim*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës,, ndërsa kjo e fundit më datë 02.10.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6354/2025 të datës 26.09.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. RN00018314 për grupin e marrëdhënieve me publikun dhe informimin për pozitën Zyrtar i Lartë për Informim; Diplomën me Nr. 1293; Diplomën me Nr. 5360 të ankueses; Njoftimin e datës 25.09.2025 për përfundimin e procedurës; Njoftimin e datës 08.09.2025 për verifikim paraprak; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 02.10.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 05.09.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankueses; Vendimin e datës 15.09.2025 për themelimin e Komisionit të pranimit; Aplikacionin e ankueses i datës 20.08.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur nga faqe 1-24; Formularin e renditjes përfundimtare i datës 25.09.2025; Njoftimin e datës 26.09.2025 për korrigjimin e njoftimit të datës 25.09.2025 për përfundimin e procedurës.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, më datën 25.07.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00018314, me emrin e Grupit të marrëdhënieve me publikun dhe informimin për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Informim”, klasa profesional 1, me afat aplikimi nga data 26.07.2025 deri më datë 24.08.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 53 kandidatë, ku sipas njoftimit të verifikimit paraprak e kanë kaluar pesëmbëdhjetë (15) kandidatë, ndërsa sipas njoftimit të datës 05.09.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, ankueses i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin: *...nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me kualifikimin arsimor sipas kërkesë së konkursit: Diplomën e arsimit të partë e nivelit të parë (bachelor) Drejtimi Gazetari/ Shkenca komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing, Kandidatja ka bashkangjitur diplomën e nivelit Bachelor drejtimi: Gjuhe dhe Letërsi Angleze, e që nuk është drejtim i kërkuar me konkurs.*

Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, më datë 25.09.2025, ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës për këtë pozitë me arsyetimin se pas përfundimit të intervistës asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur numrin e pikëve të kërkuara për emërim, ndërsa më datë 26.09.2025 ka bërë korrigjimin e njoftimit të datës 25.09.2025,sa i përket numrit të referencës së konkursit që duhet të jetë RN00018314 dhe fjalën “Intervistë” e ka zëvendësuar me fjalën: “Testimit me shkrim”.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 05.09.2025, për refuzimin e aplikacionit, pretendon se akti i kundërshtuar me ankesë është nxjerr pa ndonjë bazë juridike sepse me vetë shpalljen e konkursit është specifikuar Gjuhë dhe Letërsi pa specifikim tjetër dhe konsideroj që drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Angleze bie brenda kësaj kategorie. Kërkon që të rishqyrtohet vendimi për refuzimin e aplikacionit dhe të lejohet të vazhdoj tutje në këtë procedurë, të anulohet njoftimi për rezultatet përfundimtare i datës 25.09.2025.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00018314 për Grupin e Marrëdhënieve me publikun dhe informimin, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Informim”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka konstatuar se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor),Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing. **Kërkesat Specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacion në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht: Nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, Nenit 39 paragrafi 1, dhe 7, ku përcaktohet: 1. *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.*

Po ashtu Kolegji ju referua, Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht nenit 7 paragrafi 1, ku përcaktohet se: “1. *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit*”.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses e cila pretendon se pa asnjë arsytim i është refuzuar aplikacioni për pozitën përkatëse, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se sipas Njoftimit të datës 05.09.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ankueses i është refuzuar aplikacioni për shkak se diploma e nivelit

bachelor drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Angleze që e posedon ankuesja nuk është drejtim i kërkuar me konkurs. Andaj me qëllim të vlerësimit të drejtë të kësaj çështje, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar aplikacionin e ankueses të datës 20.08.2025, dhe ka konstatuar se ankuesja me rastin e aplikimit ka bashkangjitur Diplomën me Nr.5360 të datës 11.03.2021 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me të cilën dëshmohet se më datës 04.02.2021 ka përfunduar Fakultetin e Filologjisë/Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze, duke marr titullin bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, në këtë rast nëse i referohemi kërkesave të përgjithshme formale, grupit të marrëdhënieve me publikun dhe informimin të përcaktuar sipas shtojcës Nr. 2, me Nr. Rendor 8, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil, si kriter i arsimit është përcaktuar *Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing*, e për rrjedhojë kriteri i arsimit Gjuhë dhe Letërsi nuk është përcaktuar sipas këtyre akteve a duhet të jetë Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze apo ndonjë gjuhë tjetër, dhe mbi këtë bazë Njësia e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse nuk ka mundur të konstatoj se kualifikimi Gjuhë dhe Letërsi Angleze nuk është kërkesë e konkursit, ngase kërkesë e konkursit ka qenë vetëm Gjuhë dhe Letërsi, dhe për rrjedhojë sipas akteve në fuqi nuk ka mundur të eliminoj nga procedurat e mëtutjeshme kandidatët që kanë arsimimin në drejtimet Gjuhë dhe Letërsi pavarësisht gjuhës. Në rrjedhën e kësaj, Kolegji i Këshillit, bazuar në analizimin e akteve normative që rregullojnë kriteret e përcaktimit të arsimit, vlerëson se ankuesja ka plotësuar këtë kërkesë të konkursit sepse ka kualifikimin e kërkuar sipas konkursit, dhe refuzimi i aplikacionit sa i përket mos plotësimit të kërkesave të konkursit lidhur me arsimimin është bërë në mënyrë të gabueshme pa u analizuar mirë gjendja faktike dhe juridike.

Mirëpo Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i provave të lëndës, gjegjësisht dëshmitë e përvojës së punës profesionale të ankueses të dorëzuar me rastin e aplikimit, konstaton se e njëjta në aplikacionin e saj të datës 20.08.2025 ka deklaruar përvojën e punës si në vijim: *nga data 01.01.2021 deri më datë 31.07.2021 në Institutin e Kosovës për Drejtësi IKD në pozitën Gazetare e re/Monitoruese, prej datës 26.07.2021 deri më datë 12.11.2021 në PECB në pozitën menaxher i ri /bashkëpunëtor i marketingut, prej datës 20.02.2023 deri më datë 01.01.2024 në Kosova 2.0 në pozitën Menaxhere e Komunitetit dhe nga data 28.10.2024 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si praktikante*, mirëpo nëse i referohemi dokumentacionit të lëndës respektivisht dokumentacionit të bashkëlidhur me aplikacionin rezulton se ka dorëzuar deklaratën e datës 06.02.2020 të nënshkruar nga vet ankuesja lidhur me punën në Institutin e Kosovës për Drejtësi, nuk ka vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi me të cilën vërtetohet kohëzgjatja e angazhimit dhe pozita, ka dorëzuar emailin e datës 12.07.2021, lidhur me punën në pozitën menaxher i ri/ bashkëpunëtor i marketingut, mirëpo nuk ka vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi me të cilën vërtetohet kohëzgjatja e angazhimit dhe pozita, ka dorëzuar emailin e datës 31.01.2023 me të cilën është njoftuar se është përzgjedhur në pozitën Menaxhere e Komunitetit në KOSOVO 2.0, por nuk vërtetohet kohëzgjatja e angazhimit dhe pozita po ashtu edhe letër rekomandimi i lëshuar më datë 30.07.2024 nga KOSOVO 2.0 nuk përcakton kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës së ankueses, ka dorëzuar emailin e datës 21.05.2025 të Udhëheqësit të Divizionit për Hartim të Legjislacionit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me të cilën e ka njoftuar ankuesen që në kuadër të vazhdimit të punës praktike, për të nënshkruar kontratën, por e njëjta për këtë praktikë nuk ka ofruar dokumentacionin respektivisht vërtetim nga institucioni përkatës me të cilën do të dëshmohej periodha e kryerjes së praktikës në këtë institucion, e për rrjedhojë sipas provave të lëndës rezulton se ka

dokument mbi të dhënat nga fondi i kursimeve pensionale por sipas Kolegjit të Këshillit, dëshmia nga fondi i kursimeve pensionale është vetëm një dokument mbështetës i përvojës së punës, ndërsa përvoja e punës dhe kohëzgjatja e marrëdhënies së punës duhet vërtetuar përmes kontratave apo vërtetimeve të lëshuar nga institucionet përkatëse. Rrjedhimisht nga shqyrtimi i provave të lëndës dhe konstatimi si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja nuk ka arritur që me dokumentacionin e dorëzuar me rastin e aplikimit të argumentoj se ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale respektivisht atë të përvojës së punës profesionale sepse nuk ka ofruar kopjet e dëshmisë së punës (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen siç është kërkuar sipas pikës 5 të konkursit.

Përkitazi me gjendjen e fakteve të prezantuara si më lartë, Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar”*, vlerëson se Njoftimi i datës 05.09.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore i AKKVP-së për refuzimin e aplikacionit të ankueses do të mbetet i ligjshëm për sa i përket refuzimit të aplikacionit, ndërsa arsyetimi i këtij njoftimi do të ndryshohet në kontekst të faktit se ankuesja nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës profesionale, ngase Divizioni i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me rastin refuzimit të aplikacionit të ankueses për shkak të arsimimit nuk ka trajtuar edhe çështjen e kriterit tjetër atë të përvojës së punës, kështu që edhe nëse do të vlerësohej nga Divizioni i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës se do të plotësohte kriterin e arsimimit do të ishte pengesë kriteri i përvojës së punës profesionale.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson faktin e pakontestueshëm që ankuesja nuk plotëson kriteret e përgjithshme formale për pranim siç parashihet me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: *“Kriteret e përgjithshme që një person duhet t’i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t’u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:.. 1.7. të ketë arsimin, **përvojën e punës profesionale** dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës”*, respektivisht kriterin e përvojës së punës profesionale, dhe duke qenë se asnjë kandidat nuk ka kaluar testin me shkrim janë plotësuar kushtet ligjore që procedura të konsiderohet pa fitues, në këtë aspekt njoftimi i datës 25.09.2025 dhe njoftimi i datës 26.09.2025 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës për përfundimin e procedurës së rekrutimit me Nr.Reference: RN00018314 për grupin e marrëdhënies me publikun dhe informimin për pozitën Zyrtar i Lartë për Informim është i drejtë dhe i ligjshëm në kuptim të nenit 9 paragrafi 4 dhe nenit 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1739/2025, datë 07/11/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses F.R;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AKKVP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.